



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:217956
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05804221

Rev.nr.163/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: A. Xh., nga Prishtina, rr. ..., të cilin e përfaqëson Anton Ukaj avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Posta dhe Telekom Kosovës, sh.a., me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5148/2020, të datës 06.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 10.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i të paditurës: Posta dhe Telekom Kosovës, sh.a., me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5148/2020, të datës 06.06.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3413/2018, të datës 05.03.2020, është vendosur: I. Aprobhet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. Xh. nga P., anulohen si i kundërligjshëm vendimi për risistemimin e punëtorit, i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr.... i datës 28.06.2010, në pikën III, të tij sa i përket gradës 1, dhe vendimin mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave mr.... të datës 07.03.2012, në pikën I, sa i përket gradës 4. II. Detyrohet e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë, që paditësit t'ia paguaj: Ndryshimin e pagës në mes të gradës 1 dhe 5, për çdo muaj duke filluar nga data 01.07.2010 e deri më datë 31.12.2011 dhe atë në emër të bruto pagës shumë prej 4,127.53 €, në emër të kontributit pensional në Trustin

Pensional të Kosovës shumën prej 202.60 €, në emër të tatimit të mbajtur në burim në dobi të Buxhetit të Kosovës shumën prej 384.94 €, ndërsa lartësia e pagës neto në shumë prej 3,464.44 €. Ndryshimin e pagës në mes të gradës 4 dhe 5 prej datës 01.01.2012 deri më datë 15.09.2012 në emër të bruto pagës shumën prej 645.40 €, kontribut pensional shumën prej 32.27 €, tatim në pagë shumën prej 61.31 €, ndërsa neto paga në shumë prej 551.82 €, të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi ashtu siç: paguajnë bankat për mjete të deponuara mbi një vit pa destinim të veçantë, nga dita e marrjes së aktgjykimit më datë 05.03.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. III. Detyrohet e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 540 €.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5148/2020, të datës 06.06.2023, është vendosur që të: Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Telekom Kosovës sh.a.,(ish Posta dhe Telekomunikacioni) me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3413/18, i datës 05.03.2020, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet i bazuar revizioni i të paditurës, të ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr.5148/2020, i datës 06.06.2023, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3413/18, i datës 05.03.2020, ashtu që padia dhe kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar, ose çështja të kthehet dhe rivendosje.

Përgjigje në revizionin e të paditurës ka paraqitur paditësi, me propozim që revizioni i të paditurës të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e ndjera S. Xh. ish bashkëshortja e paditësit, më datë 25.11.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e diferencës së pagës, duke kërkuar më saktësisht si në kërkesëpadi, të precizuar në seancën e datës 19.02.2020.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë se paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.3413/2018, të datës 05.03.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: vendimi nr.... të datës 28.06.2010, ankesën e datës ..., vendimin ... të datës 27.02.2012, aktvendimin nr. ... të datës 07.03.2012, vendimin ... të datës 19.10.2012,

aktvendimin nr.... të datës 09.11.2012, ankesën e datës 16.09.2014, aktvendimin LRP.nr.... të datës 26.11.2015, mbi trashëgimin, certifikatën e martesës të datës..., ekspertizën financiare të datës 09.12.2019 dhe plotësimin e saj të datës 24.02.2020.

Ka shtuar se pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse tani e ndjera S. Xh. dhe e paditura raportin e tyre kontraktual punëdhënës - punëmarrës e kanë të rregulluar me kontratë, duke përcaktuar të drejta dhe detyrime reciproke në mes tyre. Gjithashtu edhe vendimet të cilat janë nxjerrë nga punëdhënësi konsiderohen pjesë përbërëse të kontratës dhe si të tilla duhet të implementohen. Është rregull i përgjithshëm dhe parim i së drejtës, se palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijojnë raportin juridik gjegjësisht marrëdhënien juridike, por po ashtu me këtë vullnet mund të ndryshojnë marrëdhënien juridike. Kështu gjykata vlerëson se vendimi nr. ... i datës 28.06.2010, mbi risistemimin e punëtorit, ka qenë shprehje e vullnetit e të dy palëve, meqë me të e ndjera është caktuar në vendin e punës punëtoare sporteli në njësinë Vala, mirëpo të njëjtës, në pikën III-të, i ka takuar e drejta sa i përket kompensimit në të ardhura mujore, për arsye se e njëjta ka kryer detyrat e punës, për periudhën kontestuese ... e deri më ..., si ..., edhe pas kësaj periudhe me vendimin nr.... të datës 07.03.2012, kur i janë caktuar të ardhurat në lartësi të gradës 4, nga data 01.02.2012 e deri më datë 15.11.2012, kurse me vendimin nr. ... të datës 09.11.2012, i caktohen të ardhurat në lartësi të gradës 5, ashtu siç ka qenë dashtë ti caktohet qysh në fillim. Në rastin konkret gjykata vlerëson se vendimi nr. ... i datës 28.06.2010 dhe vendimi nr.... i datës 07.03.2012, i të paditurës kanë cenuar të drejtën e tani të ndjerës S. Xh., në realizimin e pagës mujore sipas gradës 5, andaj i anuloi si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi, sa i përket nenit III, të vendimit përkatësisht gradës 1 dhe 4, si të kundërligjshëm. Gjykata e ka aprovuar padinë e paditësit A. Xh., duke u mbështetur në aktvendimi LRP.nr.. të datës 26.11.2015, mbi trashëgimin të përpiluar te N. I. A., nga i cili gjykata ka vërtetuar se paditësi A. Xh., është shpallë trashëgimtarë në tërë masën trashëgimore të mbetur pas vdekjes së trashëgimlënëses S. Xh., e nga certifikata e martesës me numër ..., lëshuar më datë 23.06.2015, është vërtetuar se paditësi dhe ish bashkëshortja e tij e ndjera S. Xh. kishin lidhur kurorë më datë ... pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Prishtinë.

Për të përcaktuar lartësinë e diferencës së pagave dhe trustit për periudhën kontestuese sipas propozimit të palës paditëse gjykata ka caktuar ekspertin financiar. Eksperti financiar gjyqësor M. M., në ekspertizën financiare të datës 09.12.2019 dhe në plotësimin e saj të datës 05.03.2020, ka konstatuar se llogaria e diferencës së pagave të paditësit nga data 01.07.2010 e deri më 31.12.2011, si diferenca e pagës bruto në mes gradës 1 dhe 5 për çdo muaj është në shumë prej 4,127.53 €, në emër të kontributit pensional në Trustin Pensional të Kosovës shuma prej 202.60 €, në emër të tatimit të mbajtur në burim në dobi të Buxhetit të Kosovës shuma prej 384.94 €, ndërsa lartësia e pagës neto në shumë prej 3,464,44 €. Ndërsa për periudhën kontestuese prej datës 01.01.2012 deri më datë 15.09.2012, sipas llogarisë, S. Xh. kishte me realizuar paga bruto në shumë prej 645.40 €, kontribut pensional shuma prej 32.27 €, tatim në pagë shuma prej 61.31 €, ndërsa neto paga në shumë prej 551.82 €. Nga administrimi i ekspertizës financiare, në cilësinë e provës materiale, gjykata ka gjetur se të ndjerës S. Xh., sikur me vendimet kontestuese në pikën III, të tyre, të i ishte caktuar grada 5 dhe jo grada 1 siç ishte përcaktuar për periudhën kontestuese prej 01.07.2010 e deri më datë 31.12.2011, dhe sikur me aktvendimin tjetër për caktimin e të ardhurave ti caktohej grada 5 dhe jo 4, e njëjta do të realizonte diferencën e të ardhura personale

ashtu siç është cekur në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit. Gjykata ekspertizën financiare e ka vlerësuar si profesionale, të argumentuar mirë, të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme dhe ia ka falur besimin për arsye se eksperti financiar ka bërë llogaritjen e diferencës së pagave dhe trustit të papaguar në mënyrë të saktë për periudhën kontestuese. Eksperti në mendimin e tij profesional në formë të shkruar dhe tabelore ka sqaruar periudhën kohore për diferencën e pagave të papaguara, pagën neto, pagën bruto, kontributin pensional të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumën e tërësishme, duke marrë për bazë të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa sa i përket asaj se pse ekspertja nuk e ka llogaritur diferencën e pagave ashtu siç e ka obliguar gjykata për periudhën kontestues nga data 28.06.2010 deri më datë 01.02.2012, e njëjta ka sqaruar për gjykatën dhe palët se llogaritjen e kësaj periudhe e ka bërë në bazë të provave të cilat i ka ofruar e paditura, ku shihet se nga pasqyra e pagave për periudhën nga data 01.07.2010 deri më datë 31.12.2011, është paguar me gradën 1, ndërsa nga data 01.01.2012, sipas provave nga e paditura, shihet se ka realizuar të ardhura sipas gradës 4, e deri më datë 15.09.2012, ndërsa që sipas vërejtjes të paditurës është përmirësuar diferenca në total prej 35.24 €.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të autorizuarës së paditurës se paditësja e ka parashtruar padinë në gjykatë pas afatit ligjor nuk qëndrojnë, pasi që gjykata në bazë të provave të administruara ka gjetur se paditësja e ndjera S. Xh. e ka parashtruar padinë në gjykatë brenda afatit ligjor të paraparë në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke qenë se e njëjta me kohë ka parashtruar ankesë të e paditura, Komisioni i Ankesave i PTK-së, me vendimin nr. ... të datës 27.02.2012, e ka aprovuar në tërësi ankesën e S. Xh., e paditura e ka ndal parashkrimin e kërkesës e me këtë edhe të padisë të saj, prandaj nga kjo bazë dhe në mbështetje të nenit 55 të Ligjit të Punës, gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit, 55, 87 të Ligjit të Punës, nenit 4, 5, 7 8 dhe 10 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Vendimin për kamatën e ka mbështetur në nenin 186, lidhur me nenin 277 të LMD-së, (1978).Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.5148/2020, të datës 06.06.2023, ka vendosur që të refuzoj ankesën e palës së paditur, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: si gjykatë e shkallës së dytë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në kuadër të shkaqeve ankimore të theksuara nga e paditura, vlerëson se përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj të pranuar, paditësit trashëgimtarë i të ndjerës S. Xh. dhe se baza juridike e kësaj kërkesë të paditësit nuk mund të vihet në dyshim me pretendimet ankimore të të paditurës, ku gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, dhe drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe i) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është mjaft i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Arsyetimi i aktgjykimit përmban arsye të mjaftueshme

për faktet vendimtare të çështjes, për provat e administruar në lidhje me vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e gjykatës në lidhje me mënyrën se si i ka vërtetuar faktet, si dhe gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancën përgatitore si dhe atë kryesore ku palëve i është dhënë e drejta për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, andaj të njëjtat në këtë drejtim u refuzuan si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërtëhënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e titullit përmbartimor dhe i përshtatshëm për përmbartim, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshinë elementet e përcaktuara sipas neni 11 të këtij ligji ”, me neni 10 paragrafi 2, pika 2.1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Kontrata e punës mundë të lidhet për një periudhë të pacaktuar ”, me nenin 10 paragrafi 3 të këtij ligji përcaktohet se: “ Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar ”, me nenin 10 paragrafi 5 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 (dhjetë) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore ”.

Me nenin 11 të Ligjit të Punës përcaktohet se: “ Çfarë duhet të përmbaj kontrata e punës ”, ndërsa me nenin 11 paragrafi 1 pika 1.8 përcaktohet se: “ Lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër ”, me nenin 55 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës ”, ndërsa me nenin 56 të këtij ligji, janë përcaktuar të drejtat në pagesë shtesë të punëtorit në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive dhe kontratën e punës.

Me vendimin e Komisionit të Ankesave të paditurës Nr. ... të datës 27.02.2012, është aprovuar ankesa e paditëses dhe është obliguar e paditura që paditëses t’ia paguaj pagën, konform gradës së përcaktuar për këtë pozitë si punëtore sporteli në njësinë Vala.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale dhe se e paditura ka për detyrim që paditësit ti bëjë kompensimin e diferencës së pagës në shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, sepse sipas vendimit Nr. ... të datës 27.02.2012, të nxjerr nga Komisioni i Ankesave, është përcaktuar se e paditura është e obliguar që tani të ndërën S. Xh. ta kompensojë sipas gradës së paraparë për këtë pozitë.

Gjykata Supreme vlerëson se nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se e ndjera ish bashkëshortja e tani paditësit sipas vendimit nr. ... të datës 28.06.2010, mbi risistemimin e punëtorit, është caktuar në vendin e punës punëtore sporteli në njësinë Vala, i cili vend i punës paguhet me gradën 5, ndërsa e njëjta është paguar me gradën 1, për periudhën nga 01.07.2010 e deri më datë 31.12.2011, ndërsa me gradën 4 për periudhën 01.01.2012 deri më datë 15.09.2012, andaj duke pas parasysh faktin se është provuar se njëjta ka punuar në pozitën që parashihet grada 5 me pëlqimin e të paditurës, gjykata vlerëson se sipas vendimit mbi risistemimin e të paditurës, e paditura është e obliguar ti paguaj paditëses diferencën e pagës për punën e kryer.

Në raport me pretendimet e të paditurës në revizion lidhur me Qëndrimin Ndërmarrës për Ndërmarrjet Publike, kjo gjykatë vlerëson se kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës, pasi që në rekomandimin e Ministrisë, nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajizuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve, duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet e të paditurës janë të pabazuara. Në këtë rast nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues.

Meqenëse e paditura me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar se ka përmbushur detyrimin e saj dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike edhe kjo gjykatë erdhi në përfundim se ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit për kompensimin e diferencës së pagës në mes gradës 1 dhe 5, për periudhën nga 01.07.2010 e deri më datë 31.12.2011, ndërsa në mes gradës 4 dhe 5, për periudhën 01.01.2012 deri më datë 15.09.2012, në shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe gjen mbështetje edhe në nenin 262 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se: “ Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është

i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij”, dhe si rezultat i kësaj meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin, e njejta ka hyrë në raport të detyrimeve me të ndjerën S. Xh., përkatësisht tani paditësin si trashëgimtar i saj, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.163/24, datë 10.06.2024

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi